

Transparenca proaktive nënkupton publikimin e informatave para se publiku t'i kërkojë ata. Kjo, sipas definicionit, korrespondon me konceptin e qeverisjes së mirë, e cila, si në teori ashtu edhe në praktikë, do të mundësonte një administratë më të mirë, më efikase dhe transparente e cila është e hapur për pjesëmarrjen e qytetarëve.

Transparenca proaktive e proklamoi edhe nismën e Partneritetit i hapur qeveritar si një iniciativë globale për hapjen e organeve qeverisëse dhe qasje më të madhe ndaj publikut.

## **PSE TRANSPARENCA PROAKTIVE ËSHTË E RËNDËSISHME PËR QYTETARËT?**

Transparenca proaktive mundëson pjesëmarrjen e qytetarëve në jetën publike të komunitetit. Koncepti i transparencës proaktive kontribuon drejtpërdrejt për demokracinë, në veçanti në cilësinë e demokracisë së drejtpërdrejtë, e cila në botën bashkëkohore arrihet përmes pjesëmarrjes së drejtpërdrejtë të qytetarëve. Aplikimi konsistent i konceptit të transparencës proaktive mund të përmirësojë ndjeshëm pjesëmarrjen e qytetarëve në vendimmarrje në të gjitha nivelet. Nëse nga qytetarët kërkohen përpjekje shtesë për t'u informuar, për shembull, duke parashtruar kërkesë për qasje në informatat me karakter publik, reduktohet gatishmëria e tyre për pjesëmarrje në procesin e vendimmarrjes si dhe vëllimi i informatave me të cilat disponojnë qytetarët. Pjesëmarrja e qytetarëve është e drejtë njerëzore dhe si e tillë është rregulluar me Deklaratën universale e të drejtave të njeriut, e miratuar në vitin 1948. Deklarata universale parashikon se:

1. " Gjithkush ka të drejtë të marrë pjesë në qeverisjen e vendit të tij, drejtpërdrejtë ose me anë të përfaqësuesve të zgjedhur lirisht."
2. Gjithkush ka të drejtë të barabartë për qasje në shërbimet publike në vendin e tij;

## **PSE TRANSPARENCA PROAKTIVE ËSHTË E RËNDËSISHME PËR POSEDUESIT E INFORMACIONIT?**

Transparenca proaktive përmbush parimin e qeverisjes së mirë. Parimi i transparencës proaktive është plotësisht në përputhje me parimet e administratës të hapur. Transparenca proaktive e zvogëlon numrin e kërkesave për qasje të lirë në informacione me karakter publik të cilat parashtrohen para poseduesve të informacioneve, dhe me këtë zvogëlohet vëllimi i punës për personin përgjegjës për ndërmjetësimin me informacionet me karakter publik.

Me shpalljen proaktive të informacioneve zbulohen:

- informacionet mbi rregulloret dhe vendimet e pushtetit, duke ushtruar kështu të drejtën e qytetarëve për t'u informuar për të drejtat dhe detyrimet e tyre në shoqëri;

- informacionet të cilat u nevojiten qytetarëve për të kërkuar përgjegjësi nga pushteti;
- informacionet të cilat u nevojiten qytetarëve për të shfrytëzuar shërbimet e ofruara nga institucionet publike;
- informacionet të cilat u nevojiten qytetarëve për të mundur të marrin pjesë në procesin e vendimmarrjes.

Edhe poseduesit e informacioneve me karakter publik të cilët publikojnë informacionet në baza proaktive përfitojnë për disa arsye:

- transparenca proaktive i ndihmon poseduesit e informacioneve të jenë më të përgjegjshëm në shpenzimin e fondeve publike;
- në këtë mënyrë, poseduesit e informacioneve promovojnë parimet e qeverisjes së mirë dhe integritetit, dhe
- Poseduesit e informacioneve janë më efikas sepse ato menaxhojnë më mirë informacionet me të cilat disponojnë.

Baza ligjore për transparencën reaktive të poseduesve të informacioneve është e rregulluar me Ligjin mbi qasjen e lirë në informata me karakter publik.

Si praktikë e mirë konsiderohet kur poseduesit e informatave, duke i publikuar ato në faqet e veta të internetit, i vënë në dispozicion të gjithë qytetarëve informatat të cilat janë kërkuar prej tyre, në përputhje me Ligjin mbi qasjen e lirë në informata me karakter publik.

Poseduesit e informacioneve janë të obliguar që në mënyrë proaktive të publikojnë të gjithë informacionet me të cilat disponojnë, përveç atyre të cilat sipas ligjit janë përjashtime nga qasja e lirë.

Informacioni i publikuar në mënyrë proaktive duhet të jetë lehtësisht i kapshëm dhe i kuptueshëm, që të mund të përdoret, të jetë i relevant dhe të përditësohet rregullisht.